



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË MESME

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Për: **Shoqërinë “Kadra” sh.p.k**

Adresa: Tirane Kamez LAKNAS Rruga Nene Tereza, Banese Private me Nr.Pasurie
180/29, Zona Kadastrale 2372

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur”/Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik për secilin lot ku te gjitha kushtet jane te përcaktuara, me objekt: **“Blerje artikuj ushqimorë për Konviktet e Shkollave të Mesme për vitin 2020”**, Fondi limit /Vlera e pritshme e kontratës **13.986.704 (trembëdhjetëmilion e nëntëqind e tetëdhjete e gjashtëmijë e shtatëqind e katër)** lekë pa tvsh- *Nr. Ref 44283-11-20-2019*

Numri i referencës së procedurës / **Loti i Tretë: “Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave te Mesme”, Nr. REF-44294-11-20-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

“Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave te Mesme”, Tirane.

Artikujt dhe sasia e parashikuar:

Nr.	Artikulli LOTI I TRETE	Njësia	Sasia e pritshme
1	VEZE	kokrra	60480
2	QUMESHT	litra	7560
3	KOS	kg	6050
4	SALÇIÇE	kg	2270
5	MISH PULE	kg	5440
6	MISH VIÇI	kg	1360
7	DJATH	kg	2840
8	GJALP	kg	1000

Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 366 (treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) ditë nga data e nënshkrimit e marrëveshjes kuadër.

Fondi limit për lotin e tretë : “Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave te Mesme” me fond limit/ vlere te pritshme te kontrates 7.322.472 (shtatëmilion e treqind e njëzet e dymijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa tvsh. Shumatorja e çmimeve për njësi: 2553.4 (dymijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre presje katër) lekë pa tvsh.

Burimi i financimit:Buxheti i Shtetit dhe buxheti i Bashkisë Tiranë.

Publikime të mëparshme : Buletini i Njoftimeve Publike Nr:47, date 25.11.2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1- Operatori ekonomik “ 4 S ” sh.p.k NUIS L64425401K

Vlera e ofertës = **7.311.600** (shtatëmilion e treqind e njëmbëdhjetëmijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH

2- Operatori ekonomik “ Dogel ” sh.p.k NUIS K59418208E

Vlera e ofertës = **5.247.450** (pesëmilion e dyqind e dyzet e shtatëmijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

3- Operatori ekonomik “Kadra ” sh.p.k NUIS
K31321008J

Vlera e ofertës = **5.709.740** (pesëmilion e shtatëqind e nëntëmijë e shtatëqind e dyzet) lekë pa TVSH.

4- Operatori ekonomik “Nelsa” shpk NUIS J71601012S

Vlera e ofertës = **6.633.880** (gjashtëmilion e gjashtëqind e tridhjetë e tremijë e tetëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. Operatori ekonomik “4 S” shpk NUIS
L64425401K

2. Operatori ekonomik “Dogel” shpk NUIS K59418208E

3. Operatori ekonomik “Nelsa” shpk NUIS J71601012S

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “4 S” shpk NUIS L64425401K

1.1 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, **pika 2.3.5** e kapacitetit teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

“Operatori ekonomik të vërtetojë se disponon Thertore të pajisur me: çertifikatë pronësie, leje higjieno sanitare, Leje mjedisore Tipit C, Liçensë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) me kodin II.1.A.(1) (thertore), çertifikatë dezinfektimi 3D si dhe raport analizën mbi përmbajtjen mikrobiologjike të ujit të përdorur në therrtore në momentin e hapjes së ofertave.

Në rastin kur operatori ekonomik ofertues e ka në pronësi therrtoren duhet të paraqesë Çertifikatën e pronësisë së therrtores dhe dokumentacionin e sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e therrtores, ndërsa në rastin kur e ka me qera, duhet të paraqesë kontratën e qerasë, çertifikatën e pronësisë dhe dokumentacionin sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e therrtores, ndërsa kur ka marrëveshje bashkëpunimit duhet të paraqesë marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur para noterit për të gjithë periudhën që kërkohet të furnizohet autoriteti kontraktor dhe dokumentacionin sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e therrtores . Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbaje të dhëna të plota si: liçensë, telefon, email, ëbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.”

Në plotësim të këtij kriteri çertifikata e dezinfektimit 3D e paraqitur nga shoqëria AB Gersa shpk per therrtore është e lëshuar më date 15.04.2019 dhe përsëritja e trajtimit duhej bërë në datë 15.07.2019 pra operatori ekonomik nuk ka vërtetuar nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur që ky proces është kryer nga operatori ekonomik në datën 15.07.2019. Çertifikata e dezinfektimit 3D e paraqitur në dokumentat e tenderit nuk është e vlefshme në datën e hapjes së procedurës duke mos plotësuar pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim kapaciteti teknik.

Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “4 S” shpk në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Lene ne fuqi nga Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 101/2020 date 06.03.2020, pas shqyrtimit te ankeses se ketij operatori.

2. Operatori ekonomik “Dogel” shpk

NUIS K59418208E

2.1 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, **pika 2.3.8** e kapacitetit teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

“ Operatori Ekonomik duhet të ketë mjet transporti ATV frigoriferik për artikujt e lotit të tretë bulmet dhe mish 2 (dy) copë , në pronësi ose në përdorim sipas kontratës noteriale, të vërtetuar me:

3. leje qarkullimi,
4. siguracion,

5. taksat e mjetit,
6. leje e transportit që leshohet nga Bashkia,
7. kontroll i mjetit,
8. leje higjeno-sanitare,
9. çertifikate pronësie.

(dokumentacioni i kerkuar te jete i vlefshëm ne perputhje me dispozitat ligjore në fuqi) ”

Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur mjetin e marrë me qera nga shoqëria SOAL shpk me targa AA 845 DS. Për këtë mjet është paraqitur çertifikata e kontrollit teknik të mjetit e skaduar më datë 11 maj 2019 dhe siguracioni i mjetit i skaduar më datë 14.05.2019. Pra mjeti nuk është paraqitur me dokumentacion të rregullt shoqerues. Është paraqitur dhe mjeti me targa AA039PJ për të cilin operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion të rregullt shoqerues. Pra nga 2 mjete vetem njëri është paraqitur me dokumentacion të rregullt shoqerues duke mos plotësuar pikën 2.3.8 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

2.2 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, **pika 2.3.4** e kapacitetit teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

“Operatori ekonomik të vërtetojë se disponon Njësi prodhimi bulmeti në pronësi/përdorim sipas kontratës noteriale të pajisur me: certificate pronësie, leje higjeno sanitare, Leje mjedisore e tipit C, Licensë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB) me kodin II.1.B, certifikatë dezinfektimi 3D si dhe raport analizën mbi përmbajtjen mikrobiologjike të ujit të përdorur nga njësitë e prodhimit të bulmetit të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.

Në rastin kur operatori ekonomik ofertues e ka në pronësi njësi prodhimi bulmeti duhet të paraqesë Çertifikatën e pronësisë dhe dokumentacionin e sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e njësisë së bulmetit, ndërsa në rastin kur e ka me qera, duhet të paraqesë kontratën e qerasë, certifikatën e pronësisë dhe dokumentacionin sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e njësisë së bulmetit, ndërsa kur ka marrëveshje bashkëpunimit duhet të paraqesë marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur para noterit për të gjithë periudhën që kërkohet të furnizohet autoriteti kontraktor dhe dokumentacionin sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e njësisë së bulmetit. Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë te dhëna te plota si: license, telefon, email, ëbsite, etj, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.”

Çertifikata e dezinfektimit 3D e paraqitur nga shoqëria Soal shpk me të cilën operatori ekonomik Dogel shpk ka lidhur kontratë bashkëpunimi për njësi prodhimi bulmeti është e lëshuar në 11.2018 dhe është e vlefshme deri me 11.2019. Pra sa më sipër çertifikata e dezinfektimit 3D e paraqitur në dokumentat e tenderit nuk është e vlefshme në datën e hapjes së procedurës. Gjithashtu për njësinë e prodhimit të bulmetit nuk është paraqitur raporti i analizës së ujit nga shoqëria “SOAL” shpk duke mos plotësuar pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta për kualifikim kapaciteti teknik.

2.3 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, **pika 2.3.5** e kapacitetit teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

“Operatori ekonomik të vërtetojë se disponon Thertore të pajisur me: certificate pronësie, leje

higjeno sanitare, Leje mjedisore Tipit C, License lëshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) me kodin II.1.A.(1) (thertore), **çertifikate dezinfektimi 3D** si dhe raport analizën mbi përmbajtjen mikrobiologjike të ujit të përdorur në therrtore në momentin e hapjes së ofertave.

Në rastin kur operatori ekonomik ofertues e ka në pronësi therrtoren duhet të paraqesë Çertifikatën e pronësisë së thertores dhe dokumentacionin e sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e therrtores, ndërsa në rastin kur e ka me qera, duhet të paraqesë kontratën e qerasë, çertifikatën e pronësisë dhe dokumentacionin sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e therrtores, ndërsa kur ka marrëveshje bashkëpunimit duhet të paraqesë marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur para noterit për të gjithë periudhën që kërkohet të furnizohet autoriteti kontraktor dhe dokumentacionin sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e therrtores . Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: licensë, telefon, email, ëbbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi. ”

Në plotësim të kësaj pike operatori ekonomik ka paraqitur një kontratë huapërdorje të lidhur me Z.Melsi Prifti por për thertoren nuk ka paraqitur çertifikatën e dizinfektimit 3D sikundër kërkohet në dokumentat e tenderit duke mos plotësuar pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim.

2.4. Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, **pika 2.3.3** e kapacitetit teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

*“Operatori ekonomik duhet të ketë **ambiente frigoriferike** në pronësi ose në përdorim sipas kontratës noteriale të pajisur me licensë QKL kodi II.1.B, leje higjeno sanitare, raport analizën e ujit, çertifikatën e dezinfektimit 3D si dhe foto të ambjentëve të ushtrimit të aktivitetit.”*

Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur një kontratë qeraje të lidhur me Znj.Lindita Laskaj por akt miratimi higjeno sanitar nuk është për ambient frigoriferik por për magazinë ushqimore si dhe nuk janë paraqitur foto të ambjentëve të ushtrimit të aktivitetit sikundër kërkohet në dokumentat e tenderit duke mos plotësuar pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim.

2.5 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, **pika 2.3.2** e kapacitetit teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

“Operatori ekonomik ofertues në rast se është vetë prodhues i produkteve blegtorale duhet të ketë të punësuar në stafin e tij një teknolog ushqimor; ndërsa në rast se nuk është vetë prodhues i produkteve blegtorale, por ka një marrëveshje bashkëpunimi duhet të vërtetojë se prodhuesi i produkteve blegtorale me të cilin ka marrëveshje bashkëpunimi të ketë të punësuar në stafin e tij një teknolog ushqimor.”

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kontrate pune, diplome, CV, librezë shëndetësore, librezë pune dhe të jetë i përfshirë në listpagesat e shoqërisë për vitin 2019.”

Në dokumentat e paraqitura në sistemin elektronik konstatohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur teknolog ushqimor duke mos plotësuar kriteret e veçanta për kualifikim, kapaciteti

teknik pika 2.3.2.

2.6 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, **pika 2.3.9** e kapacitetit teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

”Operatori ekonomik të paraqesë rregjistrat e monitorimit të temperaturave për periudhën e vitit 2019 për Frigoriferët e instaluar në ambientet e ushtrimit të aktivitetit sipas Udhëzimit të Ministrit të Bujqësisë Nr. 22 datë 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të vecanta të higjenës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor”

Operatori ekonomik Dogel shpk nuk ka paraqitur rregjistrat e monitorimit për ambientet frigoriferike duke mos plotësuar piken 2.3.9 të kriterëve të vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “Dogel” shpk në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Operatori ekonomik “Nelsa” shpk

NUIS J71601012S

3.1 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, **pika 2.3.5** e kapacitetit teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

“Operatori ekonomik të vertetojë se disponon Thertore të pajisur me: çertifikatë pronësie, leje higjeno sanitare, Leje mjedisore Tipit C, Licensë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) me kodin II.1.A.(1) (thertore), çertifikatë dezinfektimi 3D si dhe raport analizën mbi përmbajtjen mikrobiologjike të ujit të përdorur në therrtore në momentin e hapjes së ofertave.

Në rastin kur operatori ekonomik ofertues e ka në pronësi therrtoren duhet të paraqesë Çertifikatën e pronësisë së thertores dhe dokumentacionin e sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e therrtores, ndërsa në rastin kur e ka me qera, duhet të paraqesë kontratën e qerasë, certifikatën e pronësisë dhe dokumentacionin sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e therrtores, ndërsa kur ka marrveshje bashkëpunimit duhet të paraqesë marrveshjen e bashkëpunimit të lidhur para noterit për të gjithë periudhën që kërkohet të furnizohet autoriteti kontraktor dhe dokumentacionin sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e therrtores. Marrveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: license, telefon, email, ëbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.”

Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur një kontratë furnizimi me Kazazi-Meat por për therrtoren nuk ka paraqitur raportin e analizës së ujit sikundër kërkohet në dokumentat e tenderit duke mos plotësuar pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim.

3.2 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, **pika 2.3.4** e kapacitetit teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

“Operatori ekonomik të vërtetojë se disponon Njësi prodhimi bulmeti në pronësi/përdorim

sipas kontratës noteriale të pajisur me: certificate pronësie, leje higjeno sanitare, Leje mjedisore e tipit C, License leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB) me kodin II.1.B, certificate dezinfektimi 3D si dhe raport analizën mbi përmbajtjen mikrobiologjike të ujit të përdorur nga njësitë e prodhimit të bulmetit të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.

Në rastin kur operatori ekonomik ofertues e ka në pronësi njësi prodhimi bulmeti duhet të paraqesë çertifikatën e pronësisë dhe dokumentacionin e sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e njësisë së bulmetit, ndërsa në rastin kur e ka me qera, duhet të paraqesë kontratën e qerasë, certifikatën e pronësisë dhe dokumentacionin sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e njësisë së bulmetit, ndërsa kur ka marrveshje bashkëpunimit duhet të paraqesë marrveshjen e bashkëpunimit të lidhur para noterit për të gjithë periudhën që kërkohet të furnizohet autoriteti kontraktor dhe dokumentacionin sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e njësisë së bulmetit. Marrveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: license, telefon, email, ëbbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.”

Në kontratën e bashkëpunimit të lidhur me Soal shpk për produkte bulmeti nuk është paraqitur certifikata e pronësisë, nuk është paraqitur certifikata e dizinfektimit 3D, raporti i analizës së ujit duke mos plotësuar kriteret e veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.4

3.3 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, **pika 2.3.3** e kapacitetit teknik kerkohej specifikisht sa me poshte:

”Operatori ekonomik duhet të ketë **ambiente frigoriferike** në pronësi ose në përdorim sipas kontratës noteriale të pajisur me license QKL kodi II.1.B, leje higjeno sanitare, raport analizen e ujit, certifikatën e dezinfektimit 3D si dhe foto të ambjentëve të ushtrimit të aktivitetit.”

Në plotësim të kësaj pike operatori ekonomik ka paraqitur një kontratë qeraje të lidhur me Znj.Lindita Laskaj por akt miratimi higjeno sanitar nuk është për ambient frigoriferik por për magazinë ushqimore si dhe nuk janë paraqitur foto të ambjentëve të ushtrimit të aktivitetit sikundër kërkohet në dokumentat e tenderit duke mos plotësuar pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim.

Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “Nelsa” shpk në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomik i suksesshëm:

Operatori ekonomik “**Kadra**” sh.p.k NUIS K31321008J me adrese Tirane Kamez LAKNAS Rruga Nene Tereza, Banese Private me Nr.Pasurie 180/29, Zona Kadastrale 2372.

Vlera e ofertës = **5.709.740** (pesëmilion e shtatëqind e nëntëmijë e shtatëqind e dyzet) **lekë pa TVSH.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë **Autoritetit Kontraktor, Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë** me adresë Rruga: Jeronim De Rada pranë Shkollës Teknike Ekonomike, tel: 355 42 23 3826 dhe kontakti i personit përgjegjës Alketa Gjyshi, Nr. Tel: 0682093450, e-mail: gjyshialketa@yahoo.com brenda 5 (pesë)ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 17.01.2020.

Ankesa: Gjatë afatit Ligjor për pritjen e ankesave të shoqërive pjesmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për Lotin e Tretë: “Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave të Mesme”, **është paraqitur ankesë nga Operatori ekonomik “4 S” shpk.**

Me date 25.01.2020, pasi është marrë në shqyrtim ankesa e operatorit ekonomik “4 S” shpk dhe pas verifikimit të pretendimeve të operatorit ekonomik referuar dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka vendosur të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “4 S” shpk.

Operatori ekonomik “4 S” shpk ka marrë përgjigje për ankesën me anë të shkresës Nr.99, datë 25.01.2020. Pas kthimit të përgjigjes nga Autoriteti Kontraktor operatorit ekonomik “4 S” shpk referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi ka ushtruar të drejtën e ankimimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datë 03.02.2020.

Pas shqyrtimit të ankesës Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit **nr. 101/2020 datë 06.03.2020, ka vendosur të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “4 S” shpk dhe të lërë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të ofertave për procedurën e prokurimit me objekt Loti III “Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave të Mesme”.**